



Projekti Shkupi 2014 dhe efektet e tij në perceptimin e identitetit maqedonas mes qytetarëve të Shkupit

Ekipi Hulumtues:

Dr. Katerina Kolozova, hulumtuese, udhëheqëse e hulumtimit

Dr. Kalina Lecevska, hulumtuese

Viktorija Borovska, MA, hulumtuese

Ana Blazeva, MA, hulumtuese

Data e publikimit: 30 Qershor 2013

Përbledhje e përgjithshme

Duke u nisur nga premisa që me anë të përohimit të simbolizmit me referenca historike dhe estetike të veçanta, përmes përohimit material kulturor (monumente dhe arkitekturë), projektit kulturor Shkupi 2014 synon të pohojë, përforcojë, dhe sigurojë me ngulm një të vërtetë historike për identitetin maqedonas si të vërtetën e vetme; raporti kërkimor që keni në dorë ka për qëllim të sigurojë një mendim rreth suksesit të Projektit përsaq u përket ambicjeve të veta. Suksesi i tij mund të matet me anë të indikatorëve të cilat pasqyrojnë perceptimin e qytetarëve të Shkupit të cilët identifikohen si "maqedonas etnik" në lidhje me aspiratat e Projektit përsaq pësqyruar të vërtetën rreth identitetit etnik, për të kontribuar në "ruajtjen e trashëgimisë kulturore"¹ dhe për të promovuar të vërtetën historike për identitetin maqedonas kombëtar dhe etnik. Ekipi kërkimor niset nga supozimi se çdo identitet është një formë narrative, çështje perceptimi dhe jo "thelb në vetvete". Andaj, studimi ka për qëllim që të krahasojë narrativën e Shtetit me narrativat e qytetarëve të Shkupit në lidhje me identitetin maqedonas, që të mësojë nëse kjo e para korrespondon me këto të dytë. Me centralitetin e statujave të Aleksandrit të Madh dhe babait të tij, Filipit të II-të, është evidente se Projekt synon të transmetojë një të vërtetë përsaq vazhdimësinë historike të pandërprerë të "vetëvetes maqedonase" nga Antikiteti, përmes periudhës Sllave nga kohët mesjetare e deri te lufta kombëtare maqedonase kundër sundimit Osman në fillim shekullin e XX, dhe projektin shoqëruesh për themelimin e një shteti të pavarur. Duke marrë parasyshë që referencat e Antikitetit dhe supozimi i një vazhdimësie historike të pandërprerë praktikisht nuk është sfiduar e as ngritur si çështje në skenën akademike në vend- me përjashtim të disave²- hulumtimi që zhvilluan gjithashtu kyç akademikët në formatin e intervistave anonime dhe panelit të mbyllur përsaq shkençtarët dhe opinionbërësit, e bërë kjo në formatin e një fokus grupi i cili ndjek udhëzime të caktuara diskutimi. Akademikët u ftuan të diskutojnë rezultatet e fituara nga fokus grupet me qytetarët e zakonshëm, të cilat nxorrën në pah perceptimin e qytetarëve të zakonshëm sa i përket narrativës identitare dhe të vërtetës historike kombëtare të cilën Projekt pretendon ta shprehë dhe çfarë qytetarët e Shkupit perceptojnë si identitet të vërtetë maqedonas dhe e ndjejnë intimisht si të tillë.

Studimi vë në dukje diskrepancën e theksuar mes perceptimit të qytetarëve të zakonshëm për "identitetin e vërtetë maqedonas" dhe atë që predikohet nga Shteti. Gjithashtu nxjerr në pah faktin se akademikët, kur i'u kërkohet të komentojnë anonimisht, pohojnë tezën për konstruktivitetin e çdo identiteti kombëtar, shprehin mosbesim fundamental të çfarë do lloj primordializmi historik dhe janë të paaftë përsaq gjetur mjete përsaq arsyetuar projektin kur ballafaqohen me faktet përsaq perceptimin e qytetarëve përsaq "të vërtetën identitare". Të gjithë akademikët si dhe qytetarët e zakonshëm të cilët morren pjesë në këtë studim kërkuan dhe i'u garantua anonimitet i plotë. Gati të gjithë ata shfaqën hapur frikën përsaq problematizuar publikisht projektin.

Rezultatet e fituara nga hulumtimi kanë për qëllim që t'ju prezentojen institucioneve të cilat më së shumti kanë investuar përsaq promovimin dhe realizimin e Projektit, konkretisht Ministrisë së Kulturës, Ministrisë për Punë të Jashtme (meqë projektin ndikon në proceset e integrimit në BE dhe në marrdhëni me shtetet fqinje)³, akademikëve të cilët heshtazi legjitimojnë çështjet historike dhe identitare të lidhura me Projektin dhe, përsaq fund, atyre aktorëve të bashkësisë ndërkombëtare të cilët duan të kuptojnë aspektet e "ndjeshme" të çështjes së identitetit në kontekstin e konfliktit me Greqinë përsaq emrin.

Fillimi i projektit Shkupi 2014 korrespondon me një sërë zhgënijimesh nga NATO-ja dhe BE-ja për shkak të shtyrjes së pafundme të anëtarësimit në të dyja organizatat si pasojë e “çështjes së emrit” mes Greqisë dhe Maqedonisë, pavarësisht faktit se vendi ka qenë kandidat anëtarë i BE-së që nga 2005-a, zhgënjime këto, të cilat kulminuan në Samitin e Bukureshtit të NATO-s në 2008-ën. Pas përfundimit të kërkimit cilësor në cilin bazohet studimi, ne argumentojmë se nëse Projekt Shkupi 2014 ka për qëllim të “shërojë egon e plagosur” të maqedonasve, ai dështron të bëjë një gjë të tillë ngaqë importon paradigmë kulturore të huaj e cila duket se e thellon akoma më shumë ndjesinë e mohimit të imponuar nga jashtë për atë se çfarë ndihet intimisht si e vërteta për identitetin maqedonas nga qytetarët e Shkupit të cilët morrën pjesë në këtë studim.

Që nga fillimi i tij më 2010-ën deri më prill të 2013-ës, si pjesë e Projektit Shkupi 2014, janë ndërtuar gjithësej 35 objekte kryesisht në stilin neoklasicist dhe janë ngritur disa në një përafrim të barokut (ndërtesa, statuja dhe monumente) me vendim dhe me fonde te siguruara nga Ministria e Kulturës, disa nga statujat më monumentale (përfshirë edhe “Luftëtarin në Kal” që përfaqëson Aleksandrin e Madh) janë ndërtuar me iniciativë të komunës Qendër (me fonde të siguruara nga Qeveria), ndërsa Qeveria ishte investuese e ndërtesave të reja monumentale të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Gjykatës Kushtetuese, fasadës në stil barok të Qeverisë dhe ca të tjera. Këto numra u prezantuan në një konferencë për shtyp të mbajtur më 22 prill të 2013-ës nga ministrja e Kulturës Znj. Elizabeta Kanceska Milevska e cila njoftoi se deri më tanë për këtë projekt është shpenzuar një shumë prej 207.872.492 eurosh.⁴

Konteksti

Projekti Shkupi 2014 është projekt kulturor dhe historik që ka për qëllim të pohojë dhe konfirmojë identitetin kombëtar, perceptimi për të cilin është se gjendet në rrezik për shkak të mohimit të së drejtës së Republikës së Maqedonisë të përdorë emrin “Maqedoni” si identifikim për shtetin, të imponuar nga Këshilli i Sigurimit pranë OKB-ës në vitin 1993⁵, vendim ky i cili pasohet nga Marrëveshja e Përkohëshme mes Republikës Helenike dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, të hyrë në fuqi më 13 shtator 1995. Që nga adoptimi i rezolutës 817 institucionet dhe organizatat ndërkombëtare të Bashkimit Evropian (si Këshilli i Evropës) i janë referuar shtetit me emrin e tij të përkohshëm “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”. Pas 18 vjetësh negociata mes Maqedonisë dhe Greqisë, zgjidhje për çështjen e emrit nuk është gjetur ndërsa në ndërkohë emri ndërkombëtarisht i njohur i Maqedonisë ka qenë “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”.

Përkundër dispozitës ligjore të bërë me nenin 11 të Marrëveshjes së Përkohëshme, sipas së cilës Greqia nuk duhet të bllokojë Maqedoninë në proceset e saj integruese në organizata ndërkombëtare dhe në lidhje shtetesh derisa negociatat janë duke u zhvilluar, dhe që Maqedonia mundet dhe duhet të anëtarësohet në trupa të tillë ndërkombëtarë duke përdorur emrin “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”, Greqia praktikisht i vuri veto anëtarësimit të Maqedonisë në NATO në Samitin e Bukureshtit⁶ të Aleancës më 3 prill 2008. Deklarata zyrëtare e samitit thotë si vijon: “Andaj ne vendosëm që ftesa për Ish Republikën e Maqedonisë do të shtyhet deri sa të arrihet një zgjidhje e pranueshme për të dyja palët për çështjen e emrit. Ne e inkurajomë rivazhdimin e negociatave sa më parë dhe presim që ato të përfundojnë sa më shpejt të jetë e mundur.” Frustrimi në vend u rrit ndjeshëm dhe një ndjesi e revoltës publike mund të vihej re. Zgjidhja⁷ e çështjes së emrit u shtua si kushti apo “benchmarku i nëntë” të cilin vendi duhet ta arrijë që të mund të fillojë me negociatat për anëtarësim. Maqedonia është vend kandidat në BE që nga 17 dhjetori i vitit 2005 me emrin e saj të përkohshëm “Ish Republika Jugosllave e

Maqedonisë” dhe përskaj raporteve pozitive dhe rekomandimeve për fillimin e negociatave nga ana e Komisionit, Këshilli Evropian akoma nuk ka marrë vendimin që ta kyçë në procesin e negociatave për anëtarësim. Pavarësisht raportit pozitiv të Z. Riçard Hovit, reportuesit të caktuar për të ndjekur progresin e vendit në procesin e integrimit në BE, të cilin e prezentojti në seancën e Parlamentit Evropian më 22 maj 2013 dhe rekomandimit të Këshillit Evropian për të filluar negociatat me vendin, çështja e anëtarësimit të Maqedonisë në BE as që u shfaq në rendin zyrtar të ditës të mbledhjes së Këshillit e cila u mbajtë më 27-28 qershor 2013.⁹

Insistimi për të inkorporuar historinë antike maqedonase në formimin e identitetit bashkëkohorë maqedonas, duket qartë se është një përgjigje, reagim ndaj frustrimit të shkaktuar nga ngjarjet që ndodhën në Samitin e NATO-s në Bukuresht më 2008-ën dhe kërkesës së drejtëpërdrejtë nga ana e KE-së që duhet zgjidhur çështja e emrit përpara fillimit zyrtar të negociatave për anëtarësim. Shkupi 2014 u anonçua në një konferencë për shtyp të organizuar nga komuna Qendër dhe qyteti i Shkupit më shkurt të 2010-ës, në një prezentim të përbashkët të prefektit të komunës Qendër Z. Vladimir Todoroviq dhe ministres së Kulturës Znj. Elizabeta Kançeska Milevska.¹⁰

Korniza teorike dhe thelbi i qasjes metodologjike

Kompleksiteti i Projektit Shkupi 2014 që përfshin procese kulturore dhe estetike, i ndihmuar nga legjitimizimi akademik, dhe që ka për qëllim të predikojë një të vërtetë -ose “të vërtetën”- për identitetin maqedonas, kërkon një analizë shumështresore të bazuar në metodin e kërkimit cilësor. Mjetet kyçe kërkimore të cilat i kemi përdorur i'u përkasin fushave të studimit të etnografisë dhe antropologjisë ndërsa interpretimi mbështetet në analizën kulturore dhe politike të natyrës shumëdimensionale të objektit të studimit. Në bazë të gjetjeve dhe interpretimit të tyre sa iu përket proceseve kulturoro-politike të mishëruara në projektin Shkupi 2014, do të propozohen mekanizma politikash për t'i kundërvënë efekteve të këtijë projekti në rrafshin e politikës vendase dhe ndërkombëtare, si dhe në atë të proceseve integruese ndëretnike në vend dhe në BE respektivisht.

Shumica e mjeteve kërkimore antropologjike dhe etnografike dhe theksimi i analizës kulturoro-politike diktohen jo vetëm nga natyra e fenomenit të subjektit të studimit, por edhe bindjes tonë se struktura kombështet dhe sistemi i saj institucional mbështeten në “kapitalin kulturor” (Bourdieu). Kjo e dyta është strukturë shoqërore dhe proces në të cilin edhe “elita” edhe “populli i zakonshëm” marrin pjesë në mënyrë të barabartë. Gjithashtu e përfshinë profilin kulturor zyrtar që një komb synon ta prezantojë ndërkombëtarisht, por edhe kulturat e përditëshme të cilat operojnë përmes kodeve të “intimitetit kulturor” (Herzfeld) dhe janë mjetet kyçe për të identifikuar veten dhe të tjetrët se i përkasin të njëjtit kolektivi. “Intimiteti kulturor” lidhet me kulturën dhe me simbolizmin e saj të cilën personi menjëherë mund ta dallojë si të njohur por prapë se prapë nuk është imazhi i vetëvetes kolektive të cilën do të donte që ta shihte një i huaj. Kultura e përditëshme dhe kodet e saj të intimitetit janë ato të cilat institucionet e shtetit i mobilizojnë dhe i përvetësojnë në procesin e ndërtimit dhe konsolidimit të narrativës zyrtare kombëtare.¹¹


Sipas teorisë së intimitetit kulturor, të Herzfeld-it, ana “e turpshme” (dhe intime) e ndjenjës për vetëveten kombëtare dhe simbolet e saj, “sanitizohet” duke ia mveshur asaj pozitën funkcionale (në shërbim) në narrativën e pastërt për vetëveten e paraqitshme ndërkombëtarisht. Me fjalë të tjera, *kultura e përditshme duhet patjetër të thirret në ndihmë dhe të mobilizohet-* ose të kyçet- në narrativën zyrtare kombëtare me qëllim që të mundësohet që ajo të miratohet ose bëhet identifikim i atij kolektivi të cilin pretendon se e përfaqëson.¹²

Pyetjet Kërkimore

- A operon "Shkupi 2014" si projekt kulturor dhe komb-formues duke zyrtarizuar një "të vërtetë" përvjetoren kombëtare me kodet egzistuese të intimitetit kulturor, që d.m.th., kulturën e përditëshme dhe trashëgiminë kulturore jomateriale? ("E vërteta" në fjalë nuk është vetëm historike por edhe estetike ose civilizuese meqë stilet e kuazi-barokut dhe neoklasizmit janë stilet e vetme që lejohen në këtë projekt.)
- Cilat janë efektet e projektit estetiko-kulturor, akademik dhe komb-formues "Shkupi 2014" në perceptimin e identitetit kombëtar? Pra, a ka ndryshime në lidhje me sensin dhe mënyrat e identifikimit me vërtetën kombëtare në krahasim me periudhën para fillimit të projektit?
- A ka konvergjencë mes narrativës zyrtare të së vërtetës për historinë dhe origjinën kombëtare dhe përvetësimit të përditshëm të saj? Nëse ka mospërputhshmëri mes narrativës zyrtare dhe diskursit të përditshëm si dhe ri-kodimit kulturor, cilat janë ato?
- Me kusht që anonimiteti është i garantuar, a do të argumentonin ekspertët dhe akademikët nga fushat përkatëse (studime kulturore, antropologji, histori, etnologji) se "lirikat kombëtare" të hartuara nga institucionet e shtetit duhet të ndjekin agjendë ndërtimi kombëtar pavarësisht perceptimit të popullatës së Shkupit (pavarësisht nëse ka konsonancë ose dissonancë mes këtyre të dyjave)?
- A e pasqyron projekti "Shkupi 2014" ndjenjën mbizotëruese ose perceptimin për identitetin kombëtar që e ndajnë qytetarët e zakonshëm të Shkupit ose fut kode kulturore të cilat perceptohen si të huaja në raport me atë se çfarë intimisht ndjehet si "identitet maqedonas"?
- A përfaqëson Projekti, si reaksion i një sërë zhgënijimesh në lidhje me anëtarasimin në BE dhe NATO, një formë efektive mbrojtjeje të "dinjitetit kombëtar" duke e pohuar dhe konfirmuar "identitetin maqedonas"?

Përshkrimi i procesit të hulumtimit në terren dhe gjetjet e tij

Faza e kërkimit cilësor përbëhej nga kombinimi i metodave në vijim: fokus grupe, intervista dhe fokus grup (i mbyllur) ekspertësh. Gjithësej 56 persona morrën pjesë në këto tre forma të fazës së kërkimit cilësor, fazë kjo e një hulumtimi tërësor, i cili në një fazë më të vonshme do të aplikojë edhe kërkim sasior i cili do të përbëhet nga kryerja e një sondazhi me një kampion (mostër) reprezentativ me 1400 të anketuar. Duke marrë përbazë gjetjet e fituara nga një sondazh i kohëve të fundit të zhvilluar nga Brima Gallup Shkup të cilat tregojnë se shumica e popullatës në Maqedoni nuk e aprovon Projektin,¹³ kërkimi ynë i planifikuar cilësorë kërkon të nxjerrë në pah arsyet për këtë mosaprovim të cilat mund¹³ të shtrihen që nga arsyet e lidhura me çështje identitare e deri te arsyet ekonomike.



I. Fokus Grupet

1.1. Kampioni (Mostra): U zbatuan diskutime me katër fokus grupe, në të cilat u përfshinë një numër prej gjithësej 40 personash. Grupet formuan një kampion reprezentativ të shoqërisë: nivelin e arsimimit, statusin shoqëror, gjininë, moshën, preferencën politike dhe përkatësinë etnike. Një nga të katër grupet përbëhej vetëm nga përfaqësues të pakicave etnike të cilët hodhën dritë mbi konvergjencat dhe divergjencat mes maqedonasve dhe grupeve të tjera etnike sa i përket perceptimit për identitetin maqedonas dhe efekteve që "Shkupi 2014" ka mbi të.

1.2. Pyetësori

Ne hartuam një pyetësor i cili është aplikativ për të gjitha nivelet e arsimimit, statusit shoqëror, moshës dhe gjinisë. Pjetjet mund të përgjigjeshin nga pikëpamja e përvojës personale, perceptimit dhe nuk kërkonin asnje shkallë ekspertize në histori ose politikë. Kuptimi i historisë – i mishëruar në kuptimin e identitetit etnik/kombëtar- që ne përdorëm në pyetësor, është ai i cili mësohet, ose fitohet kryesisht përmes kulturës së përditëshme. Me termin kulturë e përditëshme, ne kuptojmë komunikimin joformal gojor brenda dhe mes individëve dhe grupeve, si dhe formave specifike të këmbimit dhe shpërfytyrimit të narrativave grandioze për origjinën dhe të vërtetën e identitetit kolektiv. Metodologjikisht, ky qëndrim është në një linjë me qasjen e studimeve historike dhe kulturore të historisë së jetës së përditshme (Alf Lüdtke; Paul Vayne).¹⁴ Në kontekstin e shoqërisë bashkëkohore, ajo çfarë ndërmjetësitet përmes komunikimit të përditshëm joformal (i cili mund të ndodhë përmes çfarëdo lloj medie komunikimi) gjithësesi përfshin ndikime nga institucionet dhe mediat mejnstrim/mbizotëruese (përfshirë edhe Internetin).


1.3.Gjetjet Kyçe:

- Ka një homogenitet të theksuar (por jo absolut: të dhënat e sakta janë të shfaqura më poshtë) mes të anketuarëve sa ju përket gati të gjitha bloqeve më madhore të pyetjeve, si p.sh. "cilat janë elementet emblematike të identitetit maqedonas", "cilën periudhë historike e shihni si përcaktuesen e identitetit kombëtar", etj.

- Ndjenja e "turpit kulturor" është e theksuar: "inferioritet", "dobësi", "mosdije se kush jemi", "mungesë vendosmërie dhe respekt për veten", "mungesë arsimimi", dhe "vetëdije më e lartë" (me të cilën, dukshëm, mendohet në të përbajturit me ato që rëndom konsiderohen si vlera Evropiane) shfaqen jo vetëm si aspekte të turpshme të cilat duhen fshehur, por edhe si "thelbi definues" i identitetit maqedonas. Është interesante të potencohet se fokus grupi i përbërë nga pakicat etnike shfaqën perceptimet e njejtë. Kështu që, aspektit të intimitetit kulturor i cili nxit turp i është dhënë statusi i të qenit "thelbi i identitetit kombëtar". Më poshtë janë të dhënat të cilat ilustrojnë gjetjet rreth kësajë çështjeje.

- Pasivitet, keqardhje përveten 21 %
- Pështjellim identiteti, inferioriteti, dhe frustrimi 32 %
- TV-lajme/politikë dhe epidemia e shikimit të telenovelave 31 %
- Mungesë arsimimi dhe njohurishë bazë 16 %

Turpi kulturor




Sa i përket mobilizimit të kulturës së përditëshme dhe “kodeve kulturore intime” të saj, gjetjet demonstrojnë një shkëputje totale të projektit “Shkupi 2014” nga çfarë njihen si - kode të intimitetit kulturor- të cilat perceptohen si karakteristika të padiskutueshme të kulturës maqedonase të ngulitura thellë në trashëgiminë e saj kulturore. Shenjat përcaktuese dhe më me vlerë të kulturës maqedonase, sipas asaj që dukej të ishte koncenzus mes të gjithë të anketuarëve, i përkasin kulturës jomateriale: muzikës dhe valleve tradicionale folklorike, ushqimit, gjuhës, dhe jetës tradicionale të lidhur me vlerat e krishtere ortodokse. Është e rëndësishme të theksohet se nuk pati përjashtim mes të anketuarve rreth kësaj çështjeje. Grupi i pakicave kombëtare konfirmoi se kishte të njejtin perceptim. Është interesante të vihet re se kodet e identifikimit, si përcaktuese të kulturës janë tradicionale, shkojnë prapa në histori në vend që të janë bashkëkohore dhe/ose urbane.

Pyetjes “Cilat elemente të kulturës mendoni se janë emblematike për identitetin maqedonas?”, iu përgjigjën me përgjigjet në vijim:

- Gjuha 29%
- Folklori dhe veshjet tradicionale 29%
- Muzika 21%
- Ushqimi 21%

Cilat elemente të kulturës mendoni se janë emblematike për identitetin maqedonas

█ Ushqimi █ Folklori dhe veshjet tradicionale █ Muzika █ Gjuha



Fokus grupi i komuniteteve tjera identifikoi elementet në vijim si emblematike për identitetin maqedonas:

- Ushqimi 40%
- Muzika 40%
- Gjuha 20%



Sa i përket periudhës historike e cila e përcakton identitetin maqedonas, gjithë të anketuarit veçan periudhat në vijim si më të rëndësishmet: periudha e "komitave", d.m.th., era e luftës gerile për shtet të pavarur e udhëhequr nga OBRM/OFRM-ja në periudhën e fundit të shek. XIX dhe fillim shek. XX, periudha e ashtuquajtur e përndritjes (Rilindja Kombëtare intelektuale që i paraprinë ose përkon me "Periudhën e Komitave", dhe, përfund partizanët (luftëtarët përfund një shtet të njojur në suaza të Jugosllavisë dhe të udhëhequr nga Partia Komuniste Jugosllave). Të anketuarit shfaqën ose kundërshtim ose indiferencë me periudhën e Antikitetit. Ndjeshjet e indiferencës ishin prezente edhe tek ata të cilët as nuk kanë gjë me, e as nuk e mbështesin ndërtimin e statujës së Aleksandrit të Madh në sheshin qëndror të Shkupit.

Cilën periudhë e konsideroni si përcaktuese të identitetit kombëtar:

- Pavarësinë (nga 1991) 13%
- Periudhën e Përndritjes (shek. XIX) 26 %
- Revolucionin (fillimi i shek. XX) 31 %
- RSFJ 30%

Cilën periudhë e konsideroni si përcaktuese të identitetit kombëtar





Figura më e rëndësishme historike, sipas të anketuarëve, është Goce Dellçevi (revolucionar i OBRM-ës në fillim të shek. XX). Nikolla Karev revolucionar i OBRM-ës, Krale Marko (personazh mitik mesjetar) dhe Aleksandri i Madh gjithashtu përmenden (secili nga një herë prej secilit të anketuar).

**Figura më e rëndësishme historike për
ndërtimin e identitetit kombëtar
Maqedonas**



Personazhet e trashëgimisë së letërsisë gojore të cilët kanë lënë gjurmë në mentalitetin maqedonas janë Itar Pejo (një dallaveraxhi mitik nga periudha Osmane, personazh i cili shfaqet edhe në folklorin e shteteve të tjera fqinje sllave, siç janë Bullgaria dhe Serbia) dhe Krale Marko (gjithashtu një personazh mitik, prezent në poezinë heroike epike, i ndarë edhe me folklore kombëtare të tjera sllave në rajonin e EJL).

- Përralla popullore maqedonase 21%
- Krale Marko 13%
- Periudha e partizanëve e Luftës së Dytë Botërore 13%
- Itar Pejo 13%
- Të tjerë (këngë gurbeti, patriotike) 8%

Sa ju përket vetë monumenteve dhe projekteve arkitekturore, nuk pati ndonjë homogenitet të madh mes të anketuarëve ashtu siç pati me pyetjet e shënuara sipër. Shumica nga ta e kundërshtojnë (67%) ndërsa një përqindje e caktuar e aprovojnë me rezervë (16%) sidomos sa i përket: teprisë në numër, stiltn, parave të shpenzuara dhe përfundimisht, sa i përket intimitetit kulturor, dhe ç'është më e rëndësishme- marginalizimi i disa etapave dhe figurave më të rëndësishme historike në favor të Antikititetit.

I. Intervistat me akademikë dhe aktivistë të shoqërisë civile

Intervistat shërbyen për të siguruar konfirmim ose që të inkudrojnë një dozë rezerve sa ju përket gjetjeve nga fokus grupet. Asnjëri nga 10 të intervistuarit nuk shprehu çudi apo befasi për gjetjet. Qëndrimi mbizotëruesh mes të intervistuarëve është se identiteti kombëtar është konstrukt diskursiv për më tepër politik, ndërsa identiteti kulturor është i rrënjosur kryesisht në historinë dhe traditën e transmetuar gojarisht. Qëndrimi dominant është se imponimet nga një pozicion fuqie me qëllim për të intervenuar dhe rikonfiguruar ndjenjën e përkatësisë kulturore dhe simbolikës së saj janë të mundshme. Rrjedhimisht, prezenca e zmadhuar e Antikitetit në sistemin arsimor mund të prodhojë një ndryshim të tillë. Gjithashtu, shumica e të intervistuarve nuk ishin të befasuar nga përkufizimi negativ i “vetëvetes maqedonase”, dhe ata mendojnë se kjo është rezultat i historisë. Me fjalë të tjera, ka gjithmonë një proces historik i cili përhap mite të caktuara historike në dëm të të tjerave: një histori e shënuar nga kontestimi i identitetit prodhon “vetëveten kulturore” të përcakëtuar nga një qëndrim vetë-mohues. Disa nga të intervistuarit theksuan se kjo situatë shpesh përdoret për të lartësuar perceptimin negativ për veten në një egzaltim të vetë-viktinizimit duke e shëndrruar atë në ndjenjë të fuqishme nacionaliste (Muzeu i Luftës Revolucionare Maqedonase i cili u ndërtua kohëve të fundit mund të jetë një konfirmim se procese të atilla për momentin promovohen dhe zbatohen nga ana e institucioneve shtetërore).

III. Debati i fokus grupit të ekspertëve rreth rezultateve të katër fokus grupeve të para

Gjashtë profesionistë nga fushat respektive (studime kulturore, antropologji, histori, shkenca politike, media dhe komunikim) komentuan rezultatet e fokus grupeve. Në përzgjedhjen e bashkëbiseduesve-pjesëmarresve u kujdesëm që këta të janë persona që nuk kanë histori të pjesëmarrjes në debatet publike politike dhe të mos kenë histori të pjesëmarrjes në asnjë formë aktiviteti partiak politik dhe të mos kenë publikuar kolumna. Të gjithë ekspertët që morrën pjesë në panelin e mbyllur me ekspertë kanë kariera akademike ndërkombëtare dhe, me këtë, nuk janë pjesë vetëm e skenës lokale akademike. Ata mendojnë se konfuzioni identitar është rezultat i kompleksitetit të historisë maqedonase, e cila ushqente idenë për një shtet maqedonas por që kurr nuk krijoi një të tillë deri në shpërbërjen e Jugosllavisë në vitin 1992. Problemi përkeqësoshet nga fakti se përderisa shoqërisë bashkëkohore i mungon kritikë e paçensuruar, ithtarët e diskursit publik të tanishëm vazhdojnë të janë të fokusuar në krijimin e miteve të reja të cilat janë historike. Neve na duhen mite bashkëkohore urbane. Ekspertet mendojnë se Maqedonia kurr nuk pati mundësinë që të ndërtojë identitetin e saj si shtet dhe/ose si komb, dhe që tentativat e saj të kohëve të fundit përfundojnë me përpjekje dëshpëruese për të fshirë elemente nga e kaluara me anë të kryerjes së “de-osmanizimit” dhe “de-jugosllavizimit”. Ky është një nga qëllimet kyçë të “Shkupit 2014”. Të gjithë ekspertët ndajnë një bindje negative rreth projektit “Shkupi 2014”. Njëri nga ata e cilësoi si “hakëmarrje nga provinca”. Përtatë, projekti nuk ka asnjë vlerë estetike, biles as efekte politike. Sipas tyre, qëllimi kryesor i tij është që të shpenzojë para dhe ky ndërtim i shpejt e shpejtë i objekteve dhe skulpturave reflekton qasjen totalitare. Te gjithë ata ndajnë një mendim kyç: Nëse qëllimi i “Shkupit 2014” ka qenë të ndërtojë ose përforcojë identitetin maqedonas, kjo është bërë në mënyrën totalisht të gabuar, duke dhunuar ndjenjën egzistuese të identitetit dhe, në këtë mënyrë, duke krijuar një huti të plotë.

Konkluzionet dhe rekomandime për politika

Si projekt komb-ndërtues, i bazuar në definimin dhe ridefinimin e kulturës kombëtare, "Shkupi 2014" nuk operon me kodet kulturore të kulturës së përditëshme dhe rrjedhimisht nuk mundëson komunikimin/transmetimin e mesazhit për identitetin në një mënyrë e cila mund të përvetësohet nga shumica kulturore dhe të integrohet në perceptimin dominues për identitetin. Rezultati është një formim kulturor i huaj dhe i tëhuajzuar në mesin e një perceptimi kulturor që mbetet indiferent ndaj tij përderisa kuptimi dhe ndjenja e intimitetit kulturor dhunohet nga një imponim i cili ngelet "trup i huaj" në raport me të. Fokus grupi i ekspertëve dhe të intervistuarit janë të njëzëshëm sa i përket mungesës së estetikës (të cilësuar si "kiç") dhe mitologizimit të papërshtatshëm të historisë. E tëra nuk korrespondon me ndjenjën mbizotëruese për identitet kombëtar ose etnik dhe me perceptimin për periudhat historike dhe estetike të cilat shihen si formuese të "identitetit maqedonas".

Rekomandime për politika

1. Me qëllim që të parandalohet ndjesia e imponimit (dhe neverisë ose indiferencës që ai krijon) të një kulture të huaj dhe të ndryshme nga ajo që personat ndjejnë si të veten, projektet arkitekturore dhe artistike me ambicje përkomb-formim duhet të respektojnë dhe të operojnë me kodet kulturore egzistuese të cilat mund të identifikohen në kulturën e përditshme dhe në histori.
2. Rekomandimi i propozuar më lartë mund të përbushet me adoptimin e një qasjeje nga poshtë-lartë, përmes së cilës në një diskutim të hapur publik me karakter sa është e mundur më të gjérë do të informojë për politikat kulturore në nivel Qeverie. Format e diskutimit publik mund të shtrihen që nga organizimi i debateve në nivel lokal e deri te organizimi i referendumit, por që do të lejojë shoqërinë civile që ti debatojë çështjet dhe të japë propozime konkrete në mënyrë të pavarrur, duke përfshirë jo vetëm aktivistë të OJQ-ve por edhe studiues dhe opinion bërës (nga të gjitha përkatësitë politike). Sondazhet duhen bërë në një mënyrë më të thollë dhe të plotë e cila do të mundësojë matjen e saktë të perceptimit të opinionit më të gjérë.
3. Për të parandaluar qëndrimin gati të njëzëshëm të opinionit ekspert sa ju përket mangësive historike dhe estetike të projekteve të kësaj natyre, është mëse e rëndësishme që të gjitha kompetencat për çështje estetike dhe historike t'ju delegohen trupave organizative, institucioneve dhe individëve të cilët posedojnë esperktime dhe kompetenca për çështje të tillë.
4. Me qëllim që të realizohet rekomandimi nr. 3, është e domosdoshme që të ketë debat rreth çështjeve historike, kulturore dhe artistike vetëm mes akademikëve, profesionistëve dhe artistëve, në një formë debati akademik dhe/ose ekspert, në vend të retorikave dominante publike të cilat përfaqësojnë një hibrid mes diskurseve poitike pseudo-akademike dhe atyre nacional-romantike. Debatet autonome mes akademikëve, ekspertëve dhe artistëve duhet të transpozojnë në diskutime për politika kulturore dhe rekomandime, të bëra nga organizata profesioniste dhe nga shoqëria civile, të cilat pastaj do të zbatohen nga institucionet e Shtetit dhe jo anasjelltas.
5. Për të përbushur rekomandimin nr. 4, është e nevojshme të sigurohen hapsira autonome dhe qasje të paçensuruar dhe pakufizuar në media që të sigurohet pjesëmarrja në debatin publik dhe dialogu me institucionet të cilat i zbatojnë politikat kulturore në vend.
6. Të integruarit e perspektivës së "multikulturalizmit" (ose ndjeshmërisë ndaj grupeve të pakicave etnike) duhet bërë në mënyrë të tillë që do të përdorë qasjen "nga poshtë-lartë" dhe do të vetëinformohet me anë të mobilizimit të kodeve kulturore egzistuese operative në grupin etnik përkatës.

FUNDNOTA

1 „Запрени сите шпекулации за Скопје 2014, Владата со детален отчет“ [“Fund i të gjitha spekulimeve rreth Shkupit 2014, Qeveria jep raport të hollësishëm”] i disponueshëm në <http://www.sitel.com.mk/zapreni-site-shpekulacii-za-skopje-2014-vladata-so-detalen-otchet>, i hapur më 22 prill 2013 “Shkupi 2014 krijoj vende pune , solli fonde në turizëm dhe përmbushi obligimin historik ndaj heonjëve maqedonas. Projekti është shtylla e identitetit maqedonas.”

2 Војислав Саракински [Vojislav Sarakinski], „Дискретната смрт на методологијата,“ [Vdekja diskrete e metodologjisë] *Историја*[Historia] 42.1-2 (2006), fq. 165-17.

3 “The Former Yugoslav Republic of Macedonia: Implementation of reforms within the framework of the high level accession dialogue and promotion of good neighbourly relations: Report from the Commission to the European Parliament and the Council”, [Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: Implementimi i reformave në kuadër të dialogut në nivel të lartë për anëtarësim dhe promovim të marrënieve përfqinjësi të mirë: Raporti i Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit] i disponueshëm në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/mk_spring_report_2013_en.pdf, publikuar më 16 prill 2013, i hapur më 29 korrik 2013.

4 „Отчет: Скопје 2014 чини 207 милиони евра,“ [“Reportim publik: Shkupi 2014 koshton 207 milion euro”] i disponueshëm në http://kanal5.com.mk/vesti_detail.asp?ID=5050, hapur më 29 qershor 2013; shihni edhe: „Околу 207 милиони евра се потрошени за Скопје 2014“, Нова Македонија (22 април 2013), i disponueshëm në <http://www.novamakedonija.com.mk/DetalNewsInstant.asp?vestInstant=17304>, hapur më 29 qershor 2013.

5 Кëshilli i Sigurimit pranë OKB-ës adoptoi [Rezolutën 817](#) (1993).

6 Edhe pse jo zyrtarisht, ngaqë nuk pati veto zyrtare por kundërshtim të fuqishëm për anëtarësimin e Maqedonisë në Alenacë, mundësia për të arrirë vendim të marrë me koncenzus nga ana e shteteve anëtare që ti jepin ftesë për anëtarësim vendit, ishte e pamundur. Aplikimi i Maqedonisë në NATO u dha në emër të “Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë”.

7 "Deklarata e Samitit të Bukureshtit: Lëshuar nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive që Morrën Pjesë në Mbledhjen e Këshillit Veri Atlantik në Bukuresht më 3 prill 2008" I disponueshëm në http://www.nato.int/cps/en/natolive/official_texts_8443.htm, hapur më 28 qershor 2013.

8 „ЦРПМ: Када Македонците се бележи пад во поддршката за зачувување на името“ [“CRPM: Tek Maqedonasit vërehet rënia e mbështetjes për të ruajtur emrin kushtetutes”] i disponueshëm në <http://www.netpress.com.mk/mk/vest.asp?id=35308&kategorija=1>, hapur më 29 qershor 2008.

9 "Mbledhjet e Këshillit Evropian: 27-28 qershor 2013 në Bruksel", të disponueshme në <http://www.european-council.europa.eu/council-meetings>, hapur më 28 qershor 2013.

10 „Преродбата го преродува Скопје“ [Rilindja rilind Shkupin], *Дневник* [Dnevnik](4 shkurt, 2010), i disponueshëm në

<http://www.dnevnik.com.mk/default.asp?ItemID=C9593E0AA8335641B88ADD0EC18566E6>, hapur më 29 qershor 2013; "U prezantua projekt Shkupi 2014," *Agjencionii Maqedonas Informativ*(4 shkurt 2010), I disponueshëm në <http://www.idividli.com.mk/vesti/makedonija/578522/>, hapur më 29 qershor 2013.

11 Michael Herzfeld, *Cultural Intimacy: Social Poetics in the Nation-State* [Intimiteti Kulturor: Lirika Shoqërore dhe Komb-Shteti](New York and London: Routledge), 3-5.

12 Ibid., 4.

13 „Brima Gallup“: Дури 57,8 проценти од анкетираните граѓани се против „Скопје 2014“ [“Brima Gallup: Deri më 57,8 përqind të populates janë kundër Shkupit 2014”] e disponueshme në

<http://www.plusinfo.mk/vest/62004/Brima-Gallup-Duri-427-procenti-od-anketiranite-gragjani-se-protiv-Skopje-2014> hapur më 28 qershor 2012.

14 Alf Lüdtke, *The History of Everyday Life: Reconstructing Historical Experiences and Ways of Life*[Historia e Jetës së Përditshme: Rikonstrukimi i Përvojave Historike dhe Mënyrave të Jetuarit], Princeton University Press, 1995; Paul Veyne, Koment i écrit l'histoire : essai d'épistémologie. Paris: Seuil, 1970.



Përkrahir nga:



**Instituti i Shkencave Shoqërore
dhe Humanë - Shkup**

**rr. 20 Tetori, nr.8. kati i dytë
1000 Shkup, Maqedoni**

**tel/fax: +389 2 3113 059
e-mail: info@isshs.edu.mk
www.isshs.edu.mk**